

Këmbë për në shkollë...



... një përjetim i sigurt

Verkehrs-Club
der Schweiz



Verkehrs-Club
der Schweiz



Informacione të tjera:

VCS Verkehrs-Club der Schweiz

Postfach 8676

3001 Bern

Tel. 0848 611 611 (tarifa normale)

www.verkehrsclub.ch

www.zu-fuss-zur-schule.ch

Porositë:

dok@verkehrsclub.ch

Impressum:

© VCS 2008

Texte: Rolf Marti (komma pr), Christine Steinmann,
Barbara Küttel, Rolf Friedli

Gestaltung und Illustrationen: Judith Zaugg, Bern



«Prit – shiko – dëgjo – ecë.

Unë shkoj këmbë për në shkollë – nga se tash jam mjaft i rritur.»

Sigurt

Ushtrimet e krijojnë mjeshtrin. Edhe në trafik. Fëmijët të cilët mësohen mjaft herët me sfidat e trafikut rrugor, fitojnë siguri. Shtegu për në shkollë është ideal që të trajnohen sjelljet në trafik ashtu si duhet hap pas hapi - për dore me prindërit dhe me shokë e shoqe.

Siguria në trafik

Fëmijët duhet të mësojnë mjaft herët të sillen drejtë në situata të ndryshme të trafikut. Nga se sa më shumë rriten aq më shpesh janë vetëm diku për në rrugë. Pjesëmarrja në trafik fillon në dorën e prindërve. Situatat e vështira duhet të ushtrohen bashkërisht. Pastaj ata kanë nevojë t`u jepet mundësia që ta përmirësojnë kompetencën në trafik. Mu për këtë është shtegu për në rrugë posaçërisht i përshtatshëm, nga se prindërit mund t`i kontrollojnë rregullisht hapat e fëmijëve të tyre. Përveç kësaj duke u përsëritur situatat standarde nguliten në kujtesë mostra të vërteta të sjelljes.

Ngasjet me taksì për në shkollë

- i pengojnë fëmijët t`i mësojnë rreziqet e trafikut rrugor,
- i kufizojnë mundësitë e tyre që t`a ushtrojnë sjelljen e vërtet
- i rrezikojnë fëmijët e tjerë me manovrat e rrezikshme në rrethinën e shkollës.



«Unë shkoj këmbë në shkollë – nga se takoj fëmijë të tjerë dhe përjetoj shumë.»

Interesant

Fëmijët duan të rriten. Edhe bota e tyre e brendshme. Në shtegun për në shkollë ata mbledhin përvojat themelore. Ata krijojnë shoqëri dhe zgjidhin konflikte; ata e zbulojnë mjedisin që i rrethon dhe një pjesë të lirisë; ata ushtrojnë pavarësimin dhe përgjegjësinë. Shkurt: Shtegu shkollor është një përjetim. Ky shteg i qon ata jo „vetëm“ për në shkollë, por edhe më larg.

Përjetimi

Shtegu për në shkollë është një hapësirë e lirë, në të cilën fëmijët nuk mund të mbikëqyren vazhdimisht nga prindërit dhe mësuesit. Përmes kësaj fëmijët mund të mbledhin të papenguar përvoja që janë të rëndësishme për zhvillimin e tyre personal. Ata lidhin kontakte sociale, e hulumtojnë me fëmijët e tjerë mjedisin që i rrethon, bëjnë zbulime në natyrë. Shkurt: Ata hulumtojnë botën me forcat e veta. Kjo u forcon sigurinë për veten dhe nxit te ta përgjegjësinë e tyre.

Ngasjet me taksì për në shkollë

- u kufizojnë fëmijëve përjetimet e përbashkëta me shokë e shoqe,
- u prishin atyre një pjesë të lirisë,
- u kufizojnë atyre zhvillimin personal.



«Unë shkoj këmbë për në shkollë – nga se unë lëviz dhe rri jashtë me qejf.»

Shëndetshëm

Lëvizjet janë të shëndetshme. Fëmijët që lëvizin shumë janë më produktiv dhe mund të koncentrohen më mirë. Lëvizjet dhe ajri i pastër parandalojnë problemet shëndetësore dhe janë të rëndësishme për zhvillimin trupor. Shtegu shkollor përshtatet më së miri si një njësi e përditshme trajnimi.

Shëndeti

Fëmijët duhet sa më shumë që është e mundur të lëvizin në ajër të pastër. Kjo nxitë zhvillimin trupor, motorik dhe atë mendor, e ngrit ndjenjën të qenit mirë dhe parandalon mbipeshën. Fëmijët që shkojnë këmbë në shkollë e integrojnë në përditshmërinë e tyre një pjesë të lëvizjeve të domosdoshme dhe të ajrit të pastër. Ata hyjnë në shkollë më të ekuilibruar, mund të koncentrohen më mirë dhe janë më produktiv.

- Ngasjet me taksì për në shkollë
- sjellin mostra sjelljeje me mangësi lëvizjeje,
 - kufizojnë mundësinë e lëvizjes së fëmijëve,
 - mund të kontribuojnë për mbipeshë.